

VENDIM
Nr. 179, datë 13.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.529, DATE 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE
QË ZOTËROHEN NGA SHTETI, TË SHOQËRIVE TREGTARE”, NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR.122, DATË 18.3.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit”, dhe te paragrafit të dyte, të nenit 3, te ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit i pikes 5, në kapitullin I, ndryshohet si më poshtë:

“Kur ka të dhëna të plota, ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të përcaktojë madhësinë e paketës së aksioneve, që i ofrohet blerësit, si dhe nxjerr urdhërin përkatës për privatizimin me tender sipas këtij vendimi”.

Procedurat e llogaritjes së saktë të madhësisë dhe shitjes së paketave të aksioneve për:

- publikun,
- ish-pronarët e truallit,
- punonjësit e shoqërisë

do të kryhen sipas kapitullit I, shkronjat “b”, “c”, “d”, të vendimit nr.119, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”.

2. Pika 4 e kapitullit X, shfuqizohet

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta